



Pranuar / Dorezuar Prijmjen/Prodato Received/Delivery	12-05-2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMESHUK	2379/2021		112



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KESHILLI I PAVARUR MBIKEQYRES PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr.206/2021**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**– Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtar si dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.206/2021 të datës 01.04.2021, të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi Rr.”Bekim Berisha” nr.6, Komuna e Pejës, kundër organit të punësimit/Komuna e Pejës, në çështjen juridike “Vlerësim i punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 11.05.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

**HEDHET POSHTË** si e palejuar ankesa numër A.nr.206/2021 e datës 01.04.2021 e parashtruar nga ankuesja

**A r s y e t i m**

Ankuesja e punësuar në Komunën e Pejës, sipas Akt emërimit të datës 02.08.2013, në pozitën “Shefe e sektorit administrativ financiar”, në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, me datën 01.04.2021 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 1526/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim civil të Kosovës, kundër vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 06.04.2021, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Pejës. Këshilli me datë 16.04.2021, ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova;** Ankesën me numër të protokollit 1526/2021 të regjistruar me numër A.nr. 206/2021 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; E-maili zyrtar i datës 11.03.2021; E-maili zyrtar i datës 12.03.2021; E-maili zyrtar i datës 12.03.2021; Ndryshimi dhe plotësimi i aktit të emërimit Form:MAP/AE/02 i datës 02.08.2013; Formulari PDP i përshkrimit të detyrave të punës për ankuesen në pozitën “Shef i sektorit administrativ-financiar”; Plani i punës për vitin 2020; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 23.02.2021 të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues të mesëm të ulët dhe profesional; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2019 të datës 08.01.2020; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2018 të datës 09.01.2019; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 06.04.2021 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigja në ankesë e datës 16.04.2021 nga Komuna e Pejës me shkresat e bashkangjitura.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses **është e pa lejuar, sepse:**

Bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht Akt Emërimit të datës 02.08.2013, rezulton se ankuesja është e punësuar në pozitën e punës “Shef i Sektorit Administrativ-Financiar” në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Pejës.

Drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Pejës, në cilësinë e udhëheqësit të drejtpërdrejtë, me datën 23.02.2021, ka bërë vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2020, për ankuesen me c’rast të njëjtën e ka vlerësuar me notë të përgjithshme mirë (3.3).

Ankuesja e pakënaqur me vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2020 të pranuar me datë 23.02.2021 nga udhëheqësja e drejtpërdrejtë e saj, me datën 01.04.2021, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës.


Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke u bazuar në provat e administruara të lëndës, respektivisht formularin e vlerësimit të rezultateve të punës të datës 23.02.2021, të dorëzuar nga organi i punësimit, ka konstatuar se ushtrimi i ankesës me datën 01.04.2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 13 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publikë, ku përcaktohet se: 1. Nëse nëpunësi civil nuk pajtohet me vlerësimin përfundimtar të mbikëqyrësit, ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil. 2. Ndërsa nëpunësi i shërbimit publik ka të drejtë ankese në Komisionin e ankesave të institucionit. 3. Afati për ushtrimin e ankesës së në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni është tridhjetë (30) ditë nga dita e marrjes së formularit të vlerësimit nga nëpunësi.

Andaj, duke u bazuar në nenin 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS Lënda A.nr.206/2021

Ardita PERÇUKU-SHYTI

  
Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Pejës
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Pejës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.